

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit


Dhjetor, 2024

Tiranë, më 17 Janar 2025: Ndryshimi vjetor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit në muajin Dhjetor 2024 është 2,4 %. Rritja më e madhe e çmimeve prej 5,4 % vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë”, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,9 %, “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” me 3,6 %, “Veshje dhe këpucë” me 3,2 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 2,9 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,7 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 1,8 %, “Shërbimi arsimor” me 1,7 %, “Shëndeti” me 1,5 %, “Komunikimi” me 1,1 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,9 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1,4 %.

Në muajin Dhjetor 2024, ndryshimi më i madh i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është 0,5 %. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të grupit “Argëtim dhe kulturë” me 1,3 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,9 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,7 %, “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” dhe “Komunikimi” me 0,4 % secili, “Veshje dhe këpucë” dhe “Transporti” me 0,3 % secili, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”, “Shëndeti” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,2 % secili, “Shërbimi arsimor” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,1 % secili.


Rritja mesatare vjetore e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në vitin 2024 është 2,6 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore dhemujore të IHÇK




Për publikim 17/01/2025

Vijon

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor**Tab. 1 Ndryshimet në përqindje matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit**

Kodi	Gjithsej	Peshat	12-24/Viti-2023	12-24/12-20	12-24/12-23	12-24/11-24
			1,000,0	3,5	19,5	2,4
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	347,2	3,4	33,3	2,7	0,7
02	Pije alkoolike dhe duhan	50,8	5,7	15,4	3,9	0,9
03	Veshje dhe këpucë	38,2	5,2	12,5	3,2	0,3
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	58,2	1,6	8,4	0,9	0,2
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	55,2	4,7	16,1	3,6	0,4
06	Shëndeti	53,2	2,3	6,5	1,5	0,2
07	Transporti	80,3	-1,8	8,7	-1,4	0,3
08	Komunikimi	19,4	1,2	5,8	1,1	0,4
09	Argëtim dhe kulturë	66,0	6,7	18,4	5,4	1,3
10	Shërbimi arsimor	43,0	4,4	9,3	1,7	0,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	151,7	4,8	14,5	2,9	0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	36,9	3,4	9,1	1,8	0,2

Fig.3 Ndryshimi vjetor i IHÇK sipas Shteteve, Dhjetor 2024¹

¹ INSTAT publikon indekset e pa rrumbullakosura, ndërsa EUROSTAT publikon indekset të rrumbullakosura me dy shifra dhjetore. Kjo mund të shkaktojë ndryshime midis tyre, për shkak të metodës së ndryshme të rrumbullakimit të përdorur nga secili institucion.

Metodologjia

Nga muaji Janar 2017, INSTAT publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i llogaritur në bazë të:

1. Rregullores së KE Nr 2016/792;
2. Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare
3. Programit të Statistikave Zyrtare, 2022-2026.

Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së Klasifikimit Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore. ECOICOP është klasifikimi i shpenzimeve i përdorur nga EUROSTAT.

Periudha referuese e çmimeve është muaji Dhjetor i vitit të mëparshëm, ndërsa periudha referuese e indeksit është muaji Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100).

Peshat për IHÇK janë llogaritur në përputhje me rregulloren e KE Nr 2019/792. Peshat reflektojnë strukturën e Shpenzimeve Monetare të Konsumit Final të familjeve shqiptare dhe jo shqiptare në territorin e Shqipërisë.

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti IHÇK shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistonë në:

- Përditësimin e peshave
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

IHÇK duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjera ndërkombëtarë.

- PËRKUFIZIME

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit koren me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezionale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

- Ngashmëritë midis IÇK dhe IHÇK

- *Qëllimi*

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- *Sistemi i klasifikimit*

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP)

- *Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve*

Përfshihen vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimikryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.

- *Të dhënat e çmimeve*

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njejtat njësi tregtare, përdorin të njëjtën klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- *Periudha referuese (bazë) t*

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudha referuese muajin Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100)

- *Metodologjia*

IÇK dhe IHÇK ndjekin metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren e Komisionit Evropian (KE), Nr 2016/792, mbi IHÇK, për hartimin dhe grumbullimin e komponentëve të indekseve të çmimeve, e cila është zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së) në bashkëpunim me Institutet Statistikore Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

- Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri
- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- *Mbulimi i produkteve*

- IÇK përmban 331 produkte
- IHÇK përmban 329 produkte
-

- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*

- Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
- IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptarë, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.

• *Peshat*

- Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
- Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

Kodi	Grupet	Peshat	
		IÇK	IHÇK
Gjithsej		100	1.000
01 Ushqime dhe pije alkoolike		34,6	347,2
02 Pije alkoolike dhe duhan		4,9	50,8
03 Veshje dhe këpucë		3,8	38,2
04 Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji		20,0	58,2
05 Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajje		7,4	55,2
06 Shëndeti		3,5	53,2
07 Transporti		6,2	80,3
08 Komunikimi		3,0	19,4
09 Argëtim dhe kulturë		2,2	66,0
10 Shërbimi arsimor		3,3	43,0
11 Hotele, kafene dhe restorante		5,6	151,7
12 Mallra dhe shërbime të ndryshme		5,5	36,9